



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:130207

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05580955

C.nr.248/2017

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditësve S, E, D dhe E1 H, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me përfaqësues të autorizuar avokat F.M nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të pronës së paluajtshme, vlera e kontestit 3,500.00 euro, më datë 16.04.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësve S, E, D dhe E1 H, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të pronës së paluajtshme, vlera e kontestit 3,500.00 euro.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi I H, me datë 20.02.2015 ka paraqitur në Gjykatë padi për kompensim të pronës së paluajtshme.

Gjykata fillimisht me datë 05.06.2015, e ka ndërprerë procedurën për 180 ditë, e cila me kërkesën e palës është vazhduar pas kësaj ndërprerje, por përsëri e ka ndërprerë me datë 07.07.2017, pas vdekjes së paditësit, e cila më pas është vazhduar nga trashëgimtarët ligjor S, E, D dhe E1 H.

Gjykata gjatë mbajtjes së shqyrtimit përgatitor me datë 05.12.2023, gjeti se padia e paditësve është jo e plotë dhe e pa qartë andaj ka obliguar të paditurit që në afatin prej 7 ditëve të bëjnë plotësimin dhe përmirësimin e padisë .

Nga procesverbali i shqyrtimit përgatitor C.nr.248/2017 të datës 05.12.2023, vërehet se në shqyrtimi ishin prezent njëri nga paditësit, E H si dhe përfaqësuesi i tyre i autorizuar av. F.M si dhe përfaqësuesi i të paditurës av.B.O, të njëjtit kanë nënshkruar procesverbalin pa vërejtje.

Në shkrep të lëndës nga dita e mbajtjes së shqyrtimit përgatitor e datës 05.12.2023, e deri më tani gjykata nuk pranuar ndonjë shkresë nga palët paditëse për plotësimin dhe përmirësimin e padisë.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të ndërmarrë nga gjykata, paditësi nuk bërë plotësimin apo përmirësimin e padisë, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 102 pika 1 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: *“ Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”,* ndërsa në pikën 4 parashihet, *“ Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 102 pika 1 dhe 3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.248/2017, më datën 16.04.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.